



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 642/4 prot.

Pogradec, më 15, 02, 2024

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj. Manjola Kamolli, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar zonja Kryetare ,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues:  
“Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec nr. 151, datë 28.12.2023 “Për miratimin e normave, kriterëve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës “Myredin Bashalli”, Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec”

Me respekt,

**KRYETARI**

**Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 2

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

PROJEKT-VENDIM

NR \_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC NR. 151, DATË 28.12.2023 "PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS "MYREDIN BASHALLI", LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC"**

Në mbështetje të shkronjës "a", shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, në pikën 11 dhe 12 të nenit 23, shkronjës "k", të nenit 54, në shkronjën "b" dhe shkronjën "gj" të nenit 64, të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 28 të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.10926, datë 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.151, datë 28.12.2023, "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", i konfirmuar me shkresën Nr.7/1 Prot., datë 10.01.2024, "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me Nr.171 Prot, datë 11.01.2024, si dhe mbështetur tek Relacioni shpjegues i Qendrës Arsimore, pranë Bashkisë Pogradec,

**KËSHILLI I BASHKISË  
VENDOSI:**



1. Në vendimin e këshillit bashkiak Pogradec nr. 151 datë 28.1.2023 "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", në pikën 1 të këtij vendimi shtohet pika 1.3 dhe pika 1.4 si më poshtë:

1.3 Shtohet një ambient i ri, i cili do të funksionojë si kopësht ose shkollë, pa qera, i ofruar nga një banor i fshatit Lin, ku do të kryhet pagesa e shpenzimeve mujore vetëm për konsumin e energjisë elektrike pranë OSHEE Pogradec dhe e konsumit të ujit të pijshëm pranë UK Pogradec sh.a.

1.4 Marrëdhëniet financiare për pagesën e shpenzimeve mujore të energjisë elektrike dhe konsumin e ujit të pijshëm për ambientin e ofruar të fillojnë nga data 10.01.2024, datë e cila përkon me konfirmimin e shkresës Nr. 7/1 Prot., deri në përfundim të kontratës.

2. Pikat e tjera nga nr.2-5 të VKB-së nr. 151, datë 28.12.2023 "Për miratimin e normave, kritereve, rregullave dhe procedurave për marrje ambienti dhe objekti me qira, të cilat do të shërbejnë si kopësht dhe shkollë për arsimin 9-vjecar, deri në përfundim të plotë të rikonstruksionit të shkollës "Myredin Bashalli", Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec", do të mbeten të pandryshuara.

3. Për zbatimin e vendimit, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Qendra Arsimore e Bashkisë si dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

4. Ky vendim hyn në fuqi, 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR  
Manjola KAMOLLI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më . . . .2024

**RELACION**

**MBI PROJEKT-VENDIMIN:**

`` PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC NR. 151, DATË 28.12.2023 "PËR MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJE AMBIENTI DHE OBJEKTI ME QIRA, TË CILAT DO TË SHËRBEJNË SI KOPËSHT DHE SHKOLLË PËR ARSIMIN 9-VJECAR, DERI NË PËRFUNDIM TË PLOTË TË RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS "MYREDIN BASHALLI", LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC"

Të nderuar këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen si një detyrim ligjor që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec për të miratuar këtë projekt-vendim për mbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Momentalisht në shkollën e fshatit Lin, Njësia Administrative Udënisht ka nisur rikonstruksioni i kësaj godine dhe për këtë arsye janë marrë masa urgjente në mënyrë që nxënësit të akomodoreshin në një ambient tjetër dhe procesi mësimor të mos ndërpritej për asnjë moment.

Falë masave të marra në kohë rekord në bashkëpunim me drejtuesin e institucionit dhe Njesisë Administrative u bë i mundur sigurimi i 3 godinave private që shërbejnë si Institucione Arsimore, ku një nga këto godina është ofruar falas nga pronari por me kushtin që çdo muaj deri në përfundim të kontratës institucioni të paguajë energjinë elektrike pranë OSHEE si edhe konsumin e ujit të pijshëm pranë UK Dega Pogradec. Gjithashtu, duke qenë se godina është marrë me qira në datën 11.01.2024, efektet financiare duhet të nisin po në këtë datë, e cila përkon me shkresën e konfirmimit nga Prefektura lidhur me godinat e marra me qira deri në rikonstruksionin e plotë të shkollës "Myredin Bashalli"

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftojme ta votoni propozimin për miratimin e projekt-vendimit ``Për marrjen e ambienteve me qira të cilat do të shërbejnë si shkollë në Bashkinë Pogradec``.

**Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim**

**Faleminderit**

**Të dhënat e Projekt-Vendimit:**

Konceptoi: Ledio Shkullaku

Pranoi: Majlinda Çuni

Miratoi: Anxhela Andoni



**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**